



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 3153/3 Prot.

Tiranë, më 21.07.2020

URDHËR

NR. 244, DATË 21.07.2020

PËR
MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR
PRIVAT, KOPSHTI "MEHMET AKIF", TIRANË.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe 42, të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbyllet e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti "Mehmet Akif", Tiranë, hapur me Urdhër nr. 236, datë 20.06.2006 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar:-Kopshti "Mehmet Akif", në emër të fondacionit "Gulistan", përfaqësuar nga z. Hayrettin Ozkul.
2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Mehmet Akif", Tiranë, ka këto detyrime:
 - a) Të kthejë pagesat e kryera për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj tyre.
 - b) Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e fëmijëve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Mehmet Akif", Tiranë.
 - c) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.
3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë të administrojë dokumentacionin e depozituar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Mehmet Akif", Tiranë.
4. Urdhri nr. 236, datë 20.06.2006 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar:-Kopshti "Mehmet Akif", shfuqizohet.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Mehmet Akif", i subjektit Fondacioni Gulistan.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR
BESA SHAHINI

